

Kurseni... duke ndarë mbeturinat tuaja

Me hyrjen e taksës mbi thasët e mbeturinave që prej janarit 2012, ju paguani eliminimin e mbeturinave tuaja që digjen, në funksion të sasisë që prodhoni. Për t'ju ndihmuar në reduktimin sa më të madh të volumit të tyre, do të gjeni më poshtë disa informata të nevojshme.

Përzjerja e mbeturinave ushqimore (komposto)



Të gjitha mbeturinat ushqimore, të përgatitura ose të gjalla, vendosen së bashku tek ena e kompostos, të tilla si: lëvozhgat e vezëve, mbeturinat e kafes ose çajit, lulet dhe bimët, pema e Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, mbeturinat vegjetale të kopshtit, shtrojat vegjetale të kafshëve të vogla (kashtë, tallash, bar i thatë). Në komposto nuk duhet të hidhet: mishi, produktet e tij, peshku, si dhe mbeturinat e tyre.

Letra



Ka të bëjë me të gjitha llojet e letrave, me përjashtim të letrave të ndotura si: shamitë, letrat e wc-së, letrat e pastrimit, amballazhi i ushqimeve. Kartoni reciklohet në mënyrë të veçantë (vihet përsëri në përdorim).

Bateritë, llampat e ndriçimit, ilaçet



Riktheni bateritë, llampat e ndriçimit dhe ilaçet në vëndet e caktuara nëpër magazinat dhe farmacitë ku i keni blerë.

Shishet e plastikës me shënjën PET



Duhet zbrazur nga ajri duke i shtypur e më pas i mbyllni me kapak dhe i ktheni në vëndet ku i keni blerë ose në kazanët e paraparë për këtë material.

Qelqi




Shishe, flakonë, kavanozë... Në vëndin e grumbullimit të tyre, të hidhen sipas ngjyrës (e bardhë, e gjelbër, ngjyrë kafeje).

Alumini, hekurishtet



Tuba, kanoçe, letra alumini, mbulesa jogurtesh, objekte... Edhe kur janë të papastra, ato reciklohen në vëndet e grumbullimit të mbeturinave, që do të thotë, vihen përsëri në përdorim.

Tekstilet



Të pastra, i vendosni nëpër thasët e destinuar për to, të cilët shpërndahen nëpër kutitë tuaja të postës dhe i dërgoni në kazanët e paraparë për tekstile, ose vendosini mbi trotuar ditën e mbledhjes së tyre.

Mbeturina të veçanta



Mbetjet e bojrave, produktet kimike, (brikolazh, kopshtari, pastrim...) rikthehen në vëndet ku janë blerë ose në njërën prej **6 qëndrave rajonale të mbledhjes** së mbeturinave speciale të pastrimit. Konsultoni : www.ne.ch/dechets tek: « spéciaux des ménages ».

Ku duhen çuar të gjitha këto mbeturina ?

Në kazanët e pikave të grumbullimit dhe nëpër qëndrat e mbeturinave : letra, kartonë, shishe plastike me shënjën PET, qelq, alumin, vaj, tekstile, hekurishte.

Nëpër magazina : aparatura/ lodra /vegla elektrike ose elektronike, bateri, llampa ndriçimi.

Në qendrën për mbeturina të veçanta : produkte mirëmbajtje të kopshtarisë, brikolazhit.

Për të hedhur në thasët e mbeturinave



Të gjitha mbetjet (shishe të tjera, objekte dhe amballazhe plastike, kutitë e lëngjeve të frutave, thasë aspiratorësh, shtrojat e maceve, letrat e papastra higjienike...).

Një taksë është vendosur mbi çmimin e thesit të mbeturinave

Nuk lejohen thasë të tjerë, përveç se thasët Neva, me çmimin zyrtar prej: 1.- për 17 l, 2.- për 35 l, 3.40 për 60l, 6.30 për 110l. Ato mund të blihen në magazinat tuaja të zakonshme.

Për më shumë informacion

Ville de Neuchâtel: <http://www.2000neu.ch>

Ville de La Chaux-de-Fonds: <http://www.letri.ch>

Ville du Locle: <http://www.lelocle.ch>

Për komunat e tjera, adresohuni drejtpërsëdrejti në zyrat komunale.

Canton de Neuchâtel: <http://www.ne.ch/environnement/dechets>

Val-de-Travers/La Côte-aux-Fées/ Les Verrières et La Brévine

Ndarja e mbeturinave bëhet në të njëjtën mënyrë, por taksa llogaritet në bazë të peshës së thesit të mbeturinave. Për më shumë informacion, adresohuni në kontrollin e banorëve (032/ 886 43 00) ose konsultoni faqen internet : www.val-de-travers.ch.